

VENDIM
Nr. 13, datë 19.1.2017

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“MC INERTE LUMZI” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 5, germa “e”; 13 dhe 21, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “MC Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “MC Inerte Lumzi” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10, gerrat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “MC Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti